



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHITES
Nr.01-060/01-7137/21 datë:23.03.2021



Npi – 01/84 Datë: 31.03.2021

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi (c) si dhe nenin 17 paragrafi (h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Ligji për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068; Statutit të Komunës, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Rregulloren Komunale për Institucionet edukativo-arsimore 01Nr.06/1795-200, dt.15.09.2010. Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e rregullt, të mbajtur më datën: 31.03.2021 aprovoi këtë:

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES KOMUNALE
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË 01Nr.06/570-60
TË DATËS 30.03.2012

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 20121, të mbajtur më: 31.03.2021, me shumicën e votave aprovoi, ndryshimet në Rregulloren Komunale për ndarjen e bursave për studentë, 01nr.06/570-60 të datës 30.03.2012, si vijon:

1. Në Rregullore, shkurtesa “DAKRS” përmirësohet me shkurtesën “DKA”.
2. Te neni 2 shtohet pika 2.2 ku thuhet: “ Kuvendi me vendim cakton sasinë e bursave për vitin akademik, sipas drejtimeve prioritare (deficitare) fakulteteve të cilët i propozon – cakton DKA”.
3. Te neni 5 shtohet pika 5.2 ku thuhet: “Drejtimet prioritare (deficitare) të fakulteteve, i cakton DKA, referuar nenit 2.2 “ .
4. Te neni 10.3. ku bëhet fjalë për Konkursin, i cili përveq pikave tjera shtohet edhe pika 10.3 pika (d) ku thuhet “ Profilet prioritare (deficitare), numri i bursave, sipas fakulteteve përkatëse, të përcaktuara në nenin 2.2” .

II


Kuvendi i Komunës ka marrë për bazë edhe rekomandimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

III

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Rregullorja u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj